



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE GJIROKASTËR

RELACIONI TEKNIK

Restaurim banesa Sarajet e Myfit Beut në Libohovë

Monument i kategorisë së dytë,

Vendodhja : Libohovë



Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001
E-mail: drtkgjirokastrer@meki.gov.al ; drmkgj@hotmail.com





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Tabela Përmbledhëse

1. Hyrje.....	3
2. Kush ishte Myfit Bej Libohova	4
3. Pershkrimi i kompozimit Arkitektonik	4
4. Muratura	4
5. Pershkrimi i gjendjes ekzistuese	5
6. Konkluzione.....	6



Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001

E-mail: drtkgjirokastrer@meki.gov.al ; drmkgj@hotmail.com





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

1. Hyrje

Sarajet e Myfit Bej Libohovës ndodhen në qendër të qytetit të Libohovës. Ajo ndodhet në krahun e majtë të bulevardit kryesor të qytetit përball sheshit “Avni Rustemi”. Është monument kulture kategori e II- të ndërtuar në vitet ‘30 të shekullit të kaluar.




Foto 1: Harta e qytetit të Libohovës



Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001

E-mail: drtkgjirokastrë@meki.gov.al ; drmkgj@hotmail.com





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Foto 2: Pozicioni i objektit ne qytetin e Libohoves

Sarajet e Myfit Beut, Libohove

2. Kush ishte Myfit Bej Libohova?

Myfid bej Libohova, diplomati i njohur i Perandorisë Osmane dhe krijuesi i asaj shqiptare, ishte tekniku që realizoi Bankën dhe monedhën kombëtare. Me emrin e tij janë të lidhura shumë aktivitete politike të para Luftës së Dytë Botërore. Për Eqerem bej Vlorën, ai ishte një burrë me cilësi dhe me një kulturë të madhe, ndërsa për Sejfi Vllamasin vetëm një mbështetës më shumë i italianëve. Këtë e ndjen po të shkosh në Libohovë, sepse të gjithë ata që janë në qytetin e vogël, të cilën paraardhësi i tyre i bëri nënprefekturë, të tregojnë me respekt varrin e tij; rrapet që mbolli me duart e tij gati 100 vjet më parë dhe patjetër sarajet e Familjes Libohova.



Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastër, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001

E-mail: drtkgjirokaster@meki.gov.al ; drmkgj@hotmail.com





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Në këto saraje, erdhi motra e Ali Pashait, Shanishaja, për të cilën i vëllai i tmerrshëm ndërtoi kalanë e famshme të Libohovës, që sot ka ende muret gjigande. Ajo bashkë me Myfidin, që vdiq gati një shekull më vonë, flenë së bashku gjumin e madh në tyrben e familjes, që gjendet në Libohovë, për ti kujtuar qytetit të vogël në këmbët e Buretos, se fillesa e lavdisë së tyre është tek ata...

- **Familja e tij:**

Arsllan Pashallinjtë nga rrjedh Mufidi kishin qenë për breza me rradhë Vezirët e Janinës dhe po ashtu dhe sundimtarët e Sanxhakut të Gjirokastrës dhe të Delvinës... e shumë e shumë herë dhe të krahinave të tjera. Mbase ishte kjo trashëgimi, që i bindi Libohovat e brezave të fundit të Perandorisë Osmane, që nuk ishin si të tjerët. Në shtëpinë e Libohovës fliteshin shumë gjuhë dhe kjo falë edukimit që kishin të gjithë anëtarët e saj. Kishin kuptuar të gjithë diçka të vetme, që do të ishte vetëm kultura që mund të ndryshonte statusin e tyre kombëtar dhe të mjedisit ku jetonin. Nga ana tjetër, dituria u jepte një status tjetër krahasuar edhe me njerëzit e tjerë të Perandorisë, ku familja e tyre ishte pa asnjë dyshim një nga më fisniket.

- **Vepra:**

Në mbarim të vitit 1926, pak kohë para vdekjes, i dha fund pjesës së parë të kujtimeve të tij politike dhe diplomatike që mbulon periudhën 1896-1927. Ato përfshijnë edhe dokumente shtetërore dhe ndërkombëtare origjinale, të pabotuara, me një rëndësi të veçantë për historinë e Shqipërisë, janë aty dhe fjalimet e debatet në Parlamentin e Stambollit në favor të pavarësisë kombëtare si dhe veprimtaria e tij në fushën diplomatike ndërkombëtare me qeveritë më të mëdha të atëhershme



Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001
E-mail: drtkgjirokastr@meki.gov.al ; drmkgj@hotmail.com





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Foto 3: Portreti I Myfit Bej Libohoves

3. Përshkrimi i kompozimit arkitektonik

Sarajet e Mufit Bej Libohoves jane nje kompleks arkitektonik me pjeset kryesore nje objekt dy katesh qe sherbente si ambjente ndihmese sot jane kthyer ne dyqane. Ne pjesen e paseme eshte nje obor i shtruar me pllaka guri dhe qe lidh kete objekt me ambjentet e fjetjes se familjareve dhe dy vila per miqte, ne te dy krahjet e baneses kryesore. Keto tre objekte perbehen nga objekti kryesor prej tre katesh ndertuar me mur guri dhe cati guri. Vilat qe sherbenin per miqte jane objekte dy kateshe me mere guri dhe mbuluar me rasa guri. Keto jane objekte pothuajse te njejta me fasad arkitektonike versnike. Ne studimin tone do te miremi me pjesen kryesore te dukshme te sarajeve e cila eshte nje banese dy kateshe me murature guri ku kati i dyte eshte i suvatuar, me llac gelqere me dritare druri dhe me nje cati te thjeshte mbuluar me rasa guri. Ne qender te objektit ka nje dore guri me harke ku ne te kalohet nga jashte ne drejtim te oborit te brendshem te sarajeve dhe ka dy shkalle qe te cojne ne katin e dyte te objektit. Kati i pare ndahet nga i dyti me dysheme druse dhe trare te futur ne muraturen e gurit. Ndarja midis dhomave

Adresa: Rruga Dr. Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastër, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001

E-mail: drtkgjirokaster@meki.gov.al ; drmkgj@hotmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

vazhdohet me muratur guri i cili ngrihet nga themeli deri ne cati.Mbulesa eshte me cati me rasa guri me nje konstrusion te perforcuar me dy brez (zhinxhira) per te perballuar hapsiren e madhe.

4. Muratura

Muret e banesës janë të ndërtuara me gurë të bardhe,dhe gurë të zi .

Ka pasur nderhyrje ne vite sidomos ndërhyrje te kryera pas viteve 1960.Ne hyrje te katit perdhe ekziston porta hyrese me hark me gur te gdhendur qe eshte funksionale. Ne kohe te ndyshme objekti ka pasur nderhyrje te ndryshme.Ne krahun e djathte eshte shtuar nje pjese nje kateshe e mbuluar me solet beton arme.Muratura ne pergjthesi eshte ne gjendje te mire.Probleme ka ne muret e oxhaqeve te cilat duhen riparuar. Muret lidhen me njeri-tjetrin nga traret e dysHEMEVE dhe tavaneve, qe tani pas nje viti nga lageshtia kane probleme.

5. Përshkrimi i gjëndjes ekzistuese

Sot banesa është në gjëndje kritike konstruktive. Duke qënë se objekti prej kohësh i është kthyer pronarëve, në gjëndjen e sotme, rezulton i braktisur dhe prej shumë vitesh me radhe nuk është mirëmbajtur. Sot, catia e objektit vënde vënde ka rënë, dhe pjesa e mbetur është gati për t’u shembur duke krijuar rrëshkitjen e tavanëve në brendësi, dysHEMEVE, dhe si pasojë mund të dëmtoje edhe muret rrethuese. Banesa është kthyer në një rrezik potencial për kalimtarët. Pjesa e poshtme, si rezultat i degradimit, atje ku ka pasur lokale, është braktisur. Kjo gje, duket nga muret me prani lagështie dhe myku dhe pamja e fasadës është jo e këndshme, duke qënë se banesa ndodhet në një pikë qendrore të qytetit të Libohoves. Në katet e sipërme pothuajse gjithë sipërfaqja e mureve është me lagështi dhe suvatimet pjesërisht shfaqin myshqe duke krijuar rrezikshmëri.



Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001

E-mail: drtkgjirokastr@meki.gov.al ; drmkgj@hotmail.com





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Catia paraqitet ne gjendje te keqe. Sic duket dhe ne foto, materiali drusor eshte i dukshme dhe ka rreshkitje te rasave te gurit

Rasa guri te kalbura nga lageshtia



Foto 4: Gjendja ekzistuese e catise



Foto 5: Gjendja ekzistuese e catise



Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastër, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001

E-mail: drtkgjirokaster@meki.gov.al ; drmkgj@hotmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

*Jane krijuar eme te medha ne cati si
pasoje e amortizimit. Materialet jane
te kalbura nga lageshtia dhe nga
mosmirembajtje ne teresi.*



Foto 6: Renie e materialeve te catise duke shkaktuar hapje ne cati

Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastër, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001

E-mail: drtkgjirokaster@meki.gov.al ; drmkgj@hotmail.com





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Fasada është në gjendje shumë të keqe. Paraqitet rënie e suvase vende vende duke krijuar një pamje aspak të këndshme



Foto 7: Gjendja e fasades



Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001

E-mail: drtkgjirokastrer@meki.gov.al ; drmkgj@hotmail.com





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Suva e rene dhe e degraduar.

*Dritare ne gjendje te keqe me
xhama te thyer*



Foto 8: Gjendja e fasades

Materiale drusore te vjeteruara



Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001
E-mail: drtkgjirokastrer@meki.gov.al ; drmkgj@hotmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

*Siperfaqe ne hyrje te fasades
ballore e mbuluar nga lageshtia
dhe myshqet*




Foto 9: Gjendja e fasades ballore



12

Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastër, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001

E-mail: drtkgjirokaster@meki.gov.al ; drmkgj@hotmail.com





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

*Siperfaqe ne hyrje te fasades
ballore e mbuluar nga lageshtia
dhe myshqet*



Foto 10: Gjendja e fasades ballore



Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001
E-mail: drtkgjirokastrer@meki.gov.al ; drmkgj@hotmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

*Suva ne gjendje shume te keqe.
Prani e lageshtise dhe myshqeve
ne nje pjese te madhe te saj*



Foto 11: Pjesa e pasme e baneses paraqet suva te rene



Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001
E-mail: drtkgjirokastrer@meki.gov.al ; drmkgj@hotmail.com





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

*Tavanine brendesi I gjithë
pothujse I rene*



Foto 12: Tavan i rezuar



Foto 13: Tavan i rezuar



Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001
E-mail: drtkgjirokastrë@meki.gov.al ; drmkgj@hotmail.com





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

*Dyshemete ne katin e siperm jane me
pllake dhe prej druri.
Gjendja e tyre eshte shume e keqe nga
lenia pas dore ne kohe*



Foto 13: Dysheme prej druri ekzistuese



Foto 14: Dysheme e shtruar me pllake ekzistuese



REPUBLIKA E SHQIPËRISË




Foto 15: Gjendja ekzistuese e nje prej dhomave



Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastër, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001

E-mail: drtkgjirokaster@meki.gov.al ; drmkgj@hotmail.com





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

6. Konkluzione

Pas verifikimeve në vend të objektit, nga stafi i DRTK Gjirokastrë, banesa në keto kushte kërkon nderhyrje të menjëhershme, për të shpëtuar konstruksionin e mureve, vecanërisht fasaden. Prishja e catisë së ngelur të objektit duhet kryer me kujdes, në të cilën duhet ngritur skeleri si në brendësi, ashtu dhe jashtë objektit për të shmangur cdo lloj rrezikshmërie. Nuk duhet të bëhet ngjitja në catinë e objektit, pasi mund të ketë shëmbje të papritur dhe të pa kontrolluar. Prishja e catisë duhet të nisë nga pjesët e shembura (te cilat janë të shumta) ku të ngrihet skela dhe të hiqen materialet si rasa e gurit dhe materiali drusor nga skela.

Per arsye se do të grumbullohen shumë materiale të dëmtuara do të krijohen disa baza. Per këtë çështje, është i rëndësishem bashkëpunimi me autoritetin bashkiak, për të caktuar vendin e hedhjes se tyre. Përderisa, nuk kemi siguri nëse objekti do të jetë i banueshem ose jo, në cati do të suportojmë vendosjen e një membrane hidroizoluese poshtë petavrës.

Hartoi relacionin:

Ing. Vasil POLO

Ing. Ardis DUKA

Ark. Rodhalia DHIMA

Vasil
Polo

Digitally signed by Vasil
Polo
Date: 2024.11.05
15:51:28 +02'00'

Sokol
Ismaili

Digitally signed by
Sokol Ismaili
Date: 2024.11.13
14:30:08 +02'00'

Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001

E-mail: drtkgjirokastr@meki.gov.al ; drmkgj@hotmail.com

18

